- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Tirana Parking u krijua si Institucion në Varësi të Bashkisë në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë Nr.48, datë 11.11.2015 për “Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë” dhe nisi vperimtarinë në mbështetje të Vendimin e Këshillit Bashkiak, Tiranë Nr.49, datë 11.11.2015 për “Miratimin e Kriteve të Përcakimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim”.

Situata Aktuale

Tirana Parking administron shërbimin e Parkimit Publik me Pagesë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim. Aktualisht, në parkimet në rrugë, qytetarët kanë mundësi të paguajnë vetëm nëpërmjet sistemit me SMS. Dhe pse kjo mënyrë pagese është e shpejtë dhe efikase, jo të gjithë kanë mundësinë (kreditet) për të bërë pagesën nëpërmjet SMS.

Gjithashtu, Inspektorëve u duhet të aksesojnë dy platforma të ndryshme për të verifikuar nëse një automjet e ka kryer pagesën e parkimit apo jo. Kjo e bën më pak efikase dhe më të ngadaltë procedurën për Inspektorët, dhe rrit mundësinë për gabime.

1. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

1.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i këtij projekti është të zhvillojë dhe implementojë një sistem software, i cili menaxhon në menyrë të shpejtë, të sigurtë dhe të besueshme procesin e parkimit të rezervuar me pagesë në qytetin e Tiranës . Përmes këtij projekti synohet:

1. Krijimi i një sistemi të unifikuar software, me platformë web dhe një aplikacion mobile, në pronësi të Tirana Parking, i cili do të ofrojë informacion rreth shërbimeve të Tirana Parking, mundësojë mënyra shtesë pagese për qytetarët si dhe mundësojë ndërveprimin me palë të treta në të ardhmen.
2. Platforma web do të jetë e hapur për t'u ndërlidhur jo vetëm me operatorët e telekomunikacionit por gjithashtu për të ofruar mundësinë e pagesave nëpërmjet aplikacioneve të palëve të treta online banking (RaiffeisenON, BKTSmart, Credins Online, etj), apo platforma të tjera të pagesave (EasyPay, Paysera, etj).
3. Aplikacioni mobile do të shërbejë jo vetëm si një mundësi për të kryer pagesën e parkimit, por gjithashtu do të ofrojë informacione dhe do të mundësojë Tirana Parking të dërgojë komunikime të ndryshme qytetarëve.
4. Kjo platformë do të jetë e hostuar në serverat e Tirana Parking dhe do të mirëmbahet 24/7 për të ofruar kontroll dhe siguri maksimale. Kjo mundëson shumë thjesht shtimin e use-cases apo shërbimeve të reja; suport për institucionet partnere si dhe zgjidhje të shpejtë për ankesat e qytetarëve.

1.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i platformës web dhe platformës mobile për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin në kohë reale të hapsirave të Tirana Parking si dhe ofrimin e mundësive të reja të pagesave për qytetarët (krahas mundësisë aktuale nëpërmjet SMS).

Ky projekt ka si qëllim t'i sigurojë stafit dhe Inspektorëve të Tirana Parking mjetet e nevojshme për të kryer detyrat e tyre funksionale, për të qënë më efektive dhe produktivë, ndërsa rrisin kështu vlerat e shërbimeve të ofruara nga Bashkia Tiranë me anën e një procesi inteligjent të lehtësimit dhe rritjes së transparencës së shërbimit të parkimit. Qëllimet e kësaj kontrate janë paraqitur si më poshtë:

1.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Operatori Ekonomik Fitues duhet të realizojë:

- Zhvillimin, instalimin dhe integrimin e software sipas moduleve dhe nënsistemeve si më poshtë vijon:
 - ✓ Moduli i Administrimit të sistemit;
 - ✓ Moduli i Raporteve/Dashboard për manaxhimin e Institucionit;
 - ✓ Moduli i Supervizimit të Inspektorëve të parkimit;
 - ✓ Moduli i Financës;

-
- ✓ Moduli i Administratorit për Konfigurime/Parametrizime;
 - ✓ Moduli API për SMS për konsumimin e shërbimit nga operatorët telefonike (Vodafone, One Albtelecom, etj.);
 - ✓ Moduli Open API për konsumimin e shërbimit për pagesat përmes palëve të treta;
 - ✓ Dokumentimi i hapave dhe teknologjisë për ndërlidhje me palët e treta;
 - ✓ Moduli i gjenerimit dhe manaxhimit të “vouchers” për qytetarët;
 - ✓ Moduli për kontrollin e mjetit nga ana e Inspektorëve;
 - ✓ Zhvillimi dhe Implementimi i Platformës mobile “Tirana Parking e-Wallet”.
 - ✓ Moduli i pagesës së parkimit direkt nga kioskat e Bashkisë Tiranë pa nevojën e aplikacionit mobile
- Dokumentimi
 - Trajnime për përdoruesit.
 - Mirëmbajtje.

2. SUPOZIMET DHE RISQET

2.1. Supozimet e Projektit

Disa nga supozimet e projektit janë:

- Vënia në dispozicion e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme për implementimin e sistemit.
- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti.

2.2. Rrisqet

Disa nga risqet që mund të konsiderohen për mbarëvatjen e projektit janë:

1. Ndryshime ligjore dhe pezullim të punës, në rastin e ndryshimeve të legjislacionit;
2. Mungesë bashkëpunimi mes sektoreve të përfshira në proces

3. QËLLIMI I PUNËS

3.1. Të Përgjithshme

Ky projekt bazohet në aktet ligjore si në vijim:

- Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”.
- Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- Ligji nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”
- Ligj Nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për Dokumentin Elektronik
- Vendim nr. 734, datë 28.8.2013 “Për krijimin e sistemit unik të regjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike.”

- Vendim Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i Ndryshuar.
- VKM Nr. 945, Datë 02.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, të ndryshuar

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Ky projekt ka si qëllim zhvillimin, implementimin e një sistem software për administrimin e pagesës së tarifës së parkimit publik nëpërmjet SMS dhe mënyrave alternative me e-Voucher, online banking, si dhe verifikimin e shlyerjes së këtij detyrimi nga përdoruesit e parkimit publik në rrugët e qytetit të Tiranës.

Për të përdorur, monitoruar dhe kuadruar me metoden e vjeljes së tarifës së parkimit publik me pagesë në rrugë, Tirana Parking do të pajiset me një platformë web që zotërohet plotësisht nga institucioni (jo thjesht të aksesojë një sistem software të palëve të treta si Vodafone dhe One siç ndodh aktualisht).

Krahas platformës web, që do të zotërohet nga Tirana Parking, duhet të zhvillohet dhe një aplikacion mobile për të lehtësuar procesin e pagesës për parkimin e qytetarëve të Tiranës nëpërmjet kësaj platforme të re mobile.

Operatori Ekonomik fitues duhet të realizojë detyrat sipas kërkesave të përshkruara. Fillimisht, në bashkëpunim me përfituesin dhe/ose kontraktuesin duke realizuar analizimin e dokumentacioneve, moduleve ekzistuese, mënyrës së ndërtimit, infrastrukturës si dhe njohje me kuadrin rregullator e bazën ligjore për këtë sistem.

Pas përfundimit të kësaj faze paraprake, operatori ekonomik fitues duhet të fillojë punën për zhvillimin e platformës dhe moduleve përkatëse si dhe integrimin e tyre duke funksionuar si një sistem i vetëm, si edhe implementimin e formave të ndryshme të pagesave nëpërmjet aplikacionit mobile, i cili do të zhvillohet si pjesë e këtij projekti. Më konkretisht, detyrat që duhet të realizohen janë:



1. Zhvillimi dhe Implementimi i Platformës web “Tirana Parking” sipas moduleve dhe komponentëve si më poshtë vijon:
 - ✓ Moduli i Administrimit të sistemit (Konfigurimeve/Parametrizime);
 - ✓ Moduli i Raporteve/Dashboard për manaxhimin e Institucionit;
 - ✓ Moduli i Supervizimit të inspektorëve të parkimit;
 - ✓ Moduli i Financës;
 - ✓ Moduli API për SMS për konsumimin e shërbimit nga operatorët telefonike (Vodafone, One etj.);
 - ✓ Moduli API për konsumimin e shërbimit për pagesat përmes palëve të treta;
 - ✓ Dokumentimi i hapave dhe teknologjisë për ndërlidhje me palët e treta;
 - ✓ Moduli i shitjes së “voucher” për qytetarët;
 - ✓ Moduli për kontrollin e mjetit nga Inspektorët;
2. Zhvillimi dhe Implementimi i Platformës mobile “Tirana Parking e-Wallet”;

-
3. Moduli i pagesës së parkimit direkt nga kioskat e Bashkisë Tiranë pa nevojën e aplikacionit mobile;
 4. Realizimi i trajnimeve për përdoruesit përmes sesioneve të trajnimit në ambientet e Tirana Parking, trajnimeve online si dhe nëpërmjet një udhëzues përdorimi të sistemit;
 5. Realizimi i Mirëmbajtjes së sistemit për një periudhë 2 vjeçare.

4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Republika e Shqipërisë, territori i Bashkisë Tiranë.

4.1.3. Grupet e synuara

- Qytetarët të cilët përdorin hapsirat publike të parkimit me pagesë në territorin e Bashkisë Tiranë;
- Subjektet të cilat mundësojnë pagesën e shërbimit të parkimit (operatorët telefonikë për SMS, banka dhe institucione financiare si BKTSmart, RaiffeisenOn, Credins Online, EasyPay, Paysera, etj.)

4.1.4. Siguria e Platformës

Sistemi duhet të jetë i qëndrueshëm e i besueshëm dhe të ofrojë në çdo kohë kontroll të integritetit dhe plotësisë së informacionit dhe i garantuar nga ndërhyrjet e pautorizuara. Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e përcaktimit të të drejtave (lexim, shkrim, kërkim, printim, eksportim, etj) në nivel moduli dhe në të dhënat që mund të aksesojnë sipas niveleve. Më specifikisht sistemi duhet të mundësojë:

- Administrim dhe konfigurim të sistemit - Sistemi duhet të mundësojë menaxhimin e përdoruesve (krijimin dhe përditësimin e profilit të përdoruesit);
- Menaxhimi i roleve - Sistemi duhet të lejojë caktimin e një ose më shumë roleve specifike për përdorues;
- Menaxhimi i përdoruesve - Sistemi duhet të lejojë aprovimin, bllokimin dhe zhbllokimin e një llogarie specifike të përdoruesit;
- Auditim i përdoruesve (logs) - Sistemi duhet të ruajë historinë e veprimeve të përdoruesit në sistem;
- Administrimi i fjalëkalimeve - Sistemi duhet të ofrojë enkriptimin e fjalëkalimeve;
- Komunikim i sigurtë - Sistemi duhet të mbështesë HTTPS/SSL;
- Sistemi duhet të ruajë gjurmë “timestamp” të login/logout;
- Panel për korrigjimin e gabimeve në hedhjen e të dhënave ose stornimin e veprimeve të kryera në menyrë të gabuar nga përdoruesit. Për këto veprime duhen ruajtur gjurmë/loge dhe koment tekst për veprimin e kërkuar;

Grupet e përdoruesve duhet të jenë si me poshtë:

1. Administratorët e sistemit (në platformën web);
2. Inspektorët (në platformën mobile);
3. Supervizor/Kryeinspektor (në platformën web);
4. Financë (në platformën web);
5. Pikat e shitjes të e-voucher (në platformën web);
6. Qytetarët (për aplikacionin mobile e-Wallet);
7. Konsumatorët e shërbimeve API (për komunikimin me operatorët telefonike Vodafone, One, etj.) dhe pagesat me palët e treta (RaiffeisenON, BKTSmart, Credins Online, EasyPay, Paysera, etj.)

Përdoruesit në platformën e Tirana Parking

Sistemi aktual është i bazuar në role, pra përdoruesit e aksesojnë sistemin me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalim. Çdo përdorues ka të drejta vetëm në fushën e tij të përgjegjësisë, në ndërfaqen përkatëse, që i shfaqet sipas pozicionit të punës dhe funksioneve që ka.

Sistemi duhet të ofrojë këto nivele përdoruesish:

- **Administratori** - Niveli më i lartë i aksesit i cili është në përdorim vetëm nga Sektori i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, ku manaxhon përdoruesit e tjerë, nxjerr raporte statistikore të ndryshme me kërkesë të drejtorive të tjera, etj.
- **Kontrollor Bashkiak / Inspektor** - Niveli i user nuk ka akses në vetë platformën web, por vetëm në aplikacionin e smartphone për të kontrolluar pagesat e parkimit të mjeteve në rrugë.
- **Kryeinspektor**- Niveli i supervizorit mund të nxjerrë raporte statistikore të ndryshme dhe të kontrollojë aktivitetin e inspektorëve të parkimit.
- **Finance** - Niveli i financës mund të nxjerrë raportet financiare që nevojiten për të bërë kuadrimet e pagesave me SMS, Voucher apo me palë të treta.

Referuar VKM Nr. 945, Datë 02.11.2012 “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, të ndryshuar, klasifikimi i bazës së të dhënave është L-D3I3K2.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
☐ D0	☐ I0	☐ K0	
☐ D1	☐ I1	☐ K1	☐ U
☐ D2	☐ I2	☒ K2	☐ M
☒ D3	☒ I3		☒ L

-
- Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.
 - Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.
 - Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

Operatori ekonomik fitues duhet të ketë parasysh dhe rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), të cilat duhet të jenë pjesë integrale e sistemit, në mënyrë që të lehtësohet dhe automatizohet sa më shumë zbatimi i tyre.

3.2. Detyrat specifike

Projekti do të nënshtrohet pesë fazave, të cilat paraqiten si më poshtë vijon:

FAZA I: Mbledhja dhe analizimi i kërkesave dhe miratimi i proceseve

Në këtë fazë do të bëhet analizimi dhe konfirmimi i bazës ligjore dhe kërkesave funksionale të sistemit, në bashkëpunim me stafin e Tirana Parking. Gjithashtu në këtë fazë do të realizohet rishikimi dhe përcaktimi i formave të pagesave dhe workflow-t për shërbimet e ndryshme si dhe reflektimet e ndryshimeve që ndodhin në proceset përkatëse.

Kërkesat duhet të jenë të dokumentuara, të zbatueshme, të matshme, të testueshme, të gjurmueshme, në lidhje me nevojat apo mundësitë e identifikuara të Tirana Parking, dhe të përcaktuara në një nivel të detajuar të mjaftueshme për hartimin e sistemit.

FAZA II: Zhvillimi

Në këtë fazë do të bëhet zhvillimi i sistemit software.

- Dizajnimi i ndërfaqeve dhe zhvillimi i sistemit front-end;
- Krijimi i bazës së të dhënave të platformës në një Sistem Relacional të bazës së të dhënave (RDBMS), i cili zbaton parimet ACID (atomizmi, qëndrueshmëri, izolim dhe qëndrueshmërinë e të dhënave);
- Zhvillimi i sistemit backend;
- Zhvillimi i aplikacionit mobile Android dhe iOS;
- Zhvillimi Ndërfaqeve të Programimit të Aplikacionit (Application Programming Interface - API), të cilat do të mundësojnë komunikimin dhe integrimin e sistemit të Tirana Parking me sistemet e palëve të treta (Operatorët Telefonike, Institucionet financiare etj.);
- Instalimi i sistemit në ambiente pune që simulojnë ambientin real ku do të funksionojë sistemi për qëllime testimi;
- etj.

FAZA III Testimi dhe trajnimi

Testimet do të bëhen për të verifikuar funksionalitetin e kodit, për qëndrueshmeri, eficientë, performancë, debug, etj. Gjatë testimit do të bëhet testimi i moduleve për të konfirmuar që secili kryen funksionin përkatës. Duhet të realizohet dhe testimi i integritetit të moduleve. Pas testimit të integritetit, sistemi do të testohet si një i tërë për funksionalitetet dhe përshtatshmërinë e tij me specifikimet teknike dhe kërkesat funksionale të kërkuara. Faza e Testimit do të shërbejë për verifikimin nëse funksionet janë plotësuar sipas parashimit, gjithashtu dhe nëse janë të pranishme dhe karakteristika jofunksionale (performancës, dokumentimi, etj). Përpara se të bëhet pranimi i sistemit do të realizohen:

- Testimi i sistemit, dokumentimi i rezultateve të tij;
- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre (nëse ka);
- Trajnimi i përdoruesve.

FAZA IV: Marrja në dorëzim i sistemit

Pasi të gjithë modulet e sistemit të jenë testuar dhe cdo gjë të jetë në rregull, do të bëhet marrja në dorëzim e sistemit. Në marrjen në dorëzim do të përfshihen kodi burim, të gjithë komponentët e tjerë software, dokumentimi i konfigurimeve përkatëse, etj.

FAZA V: Mirëmbajtja

Mirëmbajtje e sistemit për të siguruar qëndrueshmërinë dhe funksionimin pa probleme për një periudhë 2 vjeçare.

Detyra të tjera:

Ofruesi i shërbimeve të lartpërmendura detyrohet që të mbështesë Tirana Parking dhe të realizojë të gjithë asistencën e nevojshme që ai apo të tretë të caktuar prej tij, të integrojnë sistemin e ri me funksionalitetet e shërbimit të pagesës aktuale me SMS (përmes Operatorëve Vodafone, One etj).

Ofruesi i shërbimeve detyrohet të ndihmojë edhe në rastet kur të dhëna ekzistuese duhet të transferohen në bazën e azhurnuar të të dhënave.

Kundrejt kushteve të mirëmbajtjes dhe trajnimit, ofruesi i shërbimit i përgjigjet në çdo kohë klientit me asistencë profesionale.

4. LOGJISTIKA DHE KOHA

4.1. Vendndodhja

Vendndodhja primare e këtij sistemi do të jetë në Datacenterin e Institucionit, pranë Tirana Parking. BCC do të jetë në një vendndodhje tjetër sipas përcaktimit të Tirana Parking.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 6 muaj nisur nga kjo datë dhe 2 vjet mirëmbajtje.

5. RAPORTIMI

5.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në origjinal dhe dy kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 20 faqesh duhet të prodhohet brenda 3 javesh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar;
- **Drafti i raportit përfundimtar** prej maksimumi 20 faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së implementimit;
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është rreth 15 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të shoqërohet me faturën përkatëse.

Çdo informacion tjetër të rëndësishëm për raportet. Për shembull:

- 1- Raport instalimi.
- 2- Raport i arkitekturës SW të sistemit.

5.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

6. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Sistemi duhet të mundësojë ndërlidhjen me regjistrat elektronikë të palëve të treta, si:

- **Me Vodafone, ONE, Albtelecom** për pagesat e kryera me SMS si fushat (lista është jo-shteruese):
 - ✓ Targa
 - ✓ Zona
 - ✓ Ora e kryerjes së pagesës
 - ✓ Ora e përfundimit të vlefshmërisë
 - ✓ Numër telefoni
 - ✓ Timestap i transaksionit
 - ✓ Etj.

-
- **Me aplikacionin që gjeneron voucher apo redeem codes** (lista është joshteruese):
 - ✓ Vlera totale e e-Voucher
 - ✓ Timestamp i gjerimit të e-voucher
 - ✓ Afati i vlefshmërisë
 - ✓ Statusi i e-Voucher
 - ✓ Të dhënat e Klientit
 - ✓ Vlera që zbritet nga Voucher në momentin që realizohet një parkim
 - ✓ Etj.
 - **Me platforma të pagesave online si EasyPay, Paysera, BKTSmart, RaiffeisenON, etj** (lista është joshteruese):
 - ✓ Targa
 - ✓ Zona
 - ✓ Ora e kryerjes së pagesës
 - ✓ Ora e përfundimit të vlefshmërisë
 - ✓ Të dhënat e Klientit
 - ✓ Timestamp i transaksionit
 - ✓ Etj.

Përveç ndërveprimeve të cilësuar më sipër, pjesë e këtij projekti është dhe implementimi i API të tjera që mund të dalin si kërkesa gjatë fazës së analizës së proceseve nga Operatori ekonomik dhe stafi i Autoritetit Kontraktor.

7. GARANCIA

Garancia e sistemit jo më pak se 24 (njëzet e katër) muaj.

8. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit të përmirësuar do të jetë për një periudhë 2 vjeçare.

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për platformen software. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/përfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo

hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 10 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor/Perfituesit brenda intervalit kohor prej 1 orë nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t’i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Palët e përfshira duhet të krijojnë një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. Mujore
 - a. Kontroll i statistikave për sistemin.
 - b. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.
2. 6-Mujore.
 - a. Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit.
 - b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve të software.
 - c. Rekomandime për upgrade të mundshme hardware.
 - d. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.

Kategoria A(Kritik/i Lartë)	Kategoria B (I Mesëm)	Kategori C (I Ulët)
Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare		
Mos funksionimi i funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime finaciare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime finaciare të konsiderushme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime finaciare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimal aktivitetin ekonomik të përdoruesve
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla

të punës së tyre.	tyre	të punës së tyre,
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Zgjidhje alternative e përkohshme [Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2.]		
Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
10 min. për të kthyer përgjigje Në vend brenda 1 ore.	30 min. për të kthyer përgjigje Në vend brenda 2 orëve	60 min. për të kthyer përgjigje Në vend brenda 4 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Krijimi i platformës web për Tirana Parking	1		
2.	Aplikacioni Mobile për inspektoret dhe qytetarët	1		
3	Modalitetet e pagesave për palë të treta	1		

4	Trajnimi i përdoruesve	2 jave		
5	Mirëmbajtje e sistemit	24 muaj		
TOTALI PA TVSH (LEKË)				

10.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4-M7	M5	M6	M7-M30
1	Faza Përgatitore dhe analizimit							
2jo	Faza e krijimit të platformës web dhe mobile							
4	Faza e integritimit dhe testimit të sistemit software.							
5	Trajnimi i përdoruesve							
6	Marrja në dorëzim							
7	Fillimi i procesit të mirëmbajtjes							

11.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe dokumentacionin teknik (mënyrën e konfigurimi të sistemit, skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues. Sistemi do të dorëzohet i shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, së bashku me setin e dokumentacionit teknik që përfshin dokumentacionin teknik të moduleve në vecanti dhe dokumentin teknik në tërësi.

12.KËRKESAT FUNKSIONALE

Menyra se si funksionon sistemi i pagimit te parkimit ne rruge me sms është paraqitur me rastin ilustrues paraqitet si më poshtë:

1. Platforma web “Tirana Parking”

1.1 Moduli i Administrimit të sistemit

Ky modul përfaqëson nivelin më i lartë i aksesit i cili është në përdorim vetëm nga Sektori i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, i cili menaxhon rolet dhe të drejtat e përdoruesve në sistem, gjeneron raporte analitike/statistikore të ndryshme me kërkesë të drejtorive të tjera etj.

Kërkesat funksionale kryesore të këtij moduli janë paraqitur si më poshtë vijon:

Funksionalitetet	Përshkrimi
Menaxhimi i përdoruesve	Sistemi duhet të mundësojë menaxhimin e roleve dhe të drejtat e përdoruesve, menaxhimin e profileve të përdoruesve si dhe veprime si bllokim apo zhblokim të aksesit të përdoruesve në sistem etj.
Auditimi i përdoruesve	Gjenerimi i raporteve për auditimin e veprimeve të përdoruesve në sistem
Auditimi i transaksioneve të pagesave	Gjenerimi i raporteve për auditimin e transaksioneve të pagesave (nga palë te trëta përmes API, nga e-Wallet etj.)

1.2 Moduli i Supervizimit të inspektorëve të parkimit.

Niveli i supervisorit mund të nxjerrë raporte statistikore të ndryshme dhe të kontrollojë aktivitetin e inspektorëve të parkimit. Kërkesat funksionale kryesore të këtij moduli janë paraqitur si më poshtë vijon:

Funksionalitetet	Përshkrimi
Monitorim i punës së inspektorëve	Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin e raporteve mbi monitorimin e punës ditore/javore/periodike të inspektorëve duke përfshirë filtra si vendndodhja e inspektorit, zona, turni etj.
Raportim përmblledhës	Gjenerimi i raporteve përmblledhës/statistikore për ngarkesën sipas zonave, inspektorëve, periudhave etj..

1.3 Moduli i Financës

Niveli i financës gjeneron raportet financiare që nevojiten për të bërë kuadrimet e pagesave me SMS, Digital Wallet, pagesa përmes palëve të treta (EasyPay, Paysera, RaiffeisenOn etj.). Kërkesat funksionale kryesore të këtij moduli janë paraqitur si më poshtë vijon:

Funksionalitetet	Përshkrimi
Kuadratim i pagesave	Sistemi duhet të mundësojë monitorimin dhe kuadratim në kohë reale të pagesave sipas tipit të tyre dhe të gjenerojë raportet financiare analitike që nevojiten për të paraqitur kuadrimet e pagesave me SMS, Digital Wallet, pagesa përmes palëve të treta (EasyPay, Paysera, RaiffeisenOn etj.). etj.
Raportim përmbledhës	Gjenerimi i raporteve përmbledhës/statistikore për pagesat sipas periudhave, zonave, inspektorëve etj..

1.4 Moduli i Konfigurimeve/Parametrizimit

Kërkesat funksionale kryesore të këtij moduli janë paraqitur si më poshtë vijon:

Funksionalitetet	Përshkrimi
Konfigurimi i të dhenave	Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin dhe menaxhimin e komponentëve si a. Rajonet b. Zonat c. Rrugët d. Kalendar e. Kontrollori f. Turnet e Kontrollorëve g. Mesazh h. Etj. të cilat shërbejnë si parametra për operimin e funksionaliteve të sistemit.
Dërgimi i mesazheve informues	Dërgimi i mesazheve informues është funksionalitet , i cili ka si qëllim të informojë inspektorët në punën e tyre
Gjenerimi i raporteve mbi historikun e	Sistemi duhet të ofrojë mundësinë për gjenerimin e raporteve, të cilat japin informacion mbi historikun e konfigurimeve.

konfigurimeve	
---------------	--

1.5 Moduli API për SMS për konsumimin e shërbimit nga operatorët telefonike (Vodafone, One etj.)

Ky modul duhet të ofrojë integrimin me shërbimin e

Funksionalitetet	Përshkrimi
API për shërbimin e SMS	Sistemi duhet të mundësojë ndërveprimin me sistemin aktual të SMS nga operatorët telefonike (Vodafone, One etj.) nepermjet një API funksional dhe të sigurtë

1.6 Moduli API për konsumimin e shërbimit për pagesat përmes palëve të treta (EasyPay, Paysera etj)

Funksionalitetet	Përshkrimi
API për shërbimin përmes palëve të treta (EasyPay, Paysera etj)	Sistemi duhet të mundësojë një API funksional dhe të sigurtë i cili të mundësoj pagesën e parkimit përmes palëve të treta (EasyPay, Paysera etj)
Dokumentim i plotë i API dhe hapave që duhen ndjekur për ndërveprimin	API i cili do të përdoret nga palët e treta, duhet të shoqërohet me një dokumentim të plote dhe shumë të detajuar ku të përfshihen të gjitha funksionet, mënyra e ndërveprimit me API, erroret e ndryshme si dhe çdo informacion që mund ti nevojitet zhvilluesve të palëve të treta për të ndërvepruar me platformën e Tirana Parking

1.7 Moduli i shitjes së “e-Voucher” për qytetarët

Sistemi duhet t’i mundësojë punonjësve të Tirana Parking, të cilët do të gjenerojnë “voucher” për klientët me funksionalitetet e mëposhtme.

Funksionalitetet	Përshkrimi
Login në sistemin web të Tirana Parking	Sistemi duhet të mundësojë login të punonjësve të autorizuar sipas kredencialeve të tyre (emërpërdoruesi dhe fjalëkalim),

Gjenerim voucher	Gjenerim i voucher bëhet përmes një ndërfaqe “user-friendly”
Printimin e voucher	Sistemi duhet te printoj voucher code në form QR code i cili do mund të përdoret nga qytetarët.
Ngarkim automatik në portofolin digjital (Digital Wallet /e-Wallet) të Klientit	Nëpërmjet aplikacionit mobile, qytetarët do mund të ngarkojnë kreditet e blera me voucher dhe ti kenë ato në portofolin digjital të tyre.
Monitorim i e-Voucher	Cdo njësi shitëse do ketë mundësinë të monitorojë shitjen dhe përdorimin e vouchers që ata gjenerojnë.
Raporte Statistikore mbi gjenerimin e e-Voucher për parkimin	Tirana Parking do ketë mundësinë të gjenerojnë raporte të ndryshme mbi shtijet dhe përdorimin e voucher-ave.
Pagesa cash në pikat e shitjes	Sistemi i shitjes së vouchers duhet të mundësojë dhe pagesat cash të parkimit nga qytetaret direkt në kioskat e Bashkisë Tiranë. Nëse një qytar deshiron të paguajë me para në dorë, në një pikë shitje, ath shitësi duhet të marrë targën e automjetit, gjenerojë një biletë parkimi për qytetarin, printojë atë dhe t’ja dorezojë qytetarit. Qytetari nuk është e nevojshme ta vendosë këtë biletë në xhamin e makinës pasi Inspektorët, kur kontrollojnë targën, do t’u shfaqet automatikisht në sistem e paguar, nëse është brenda afatit për të cilën qytetari ka paguar.

1.8 Moduli për kontrollin nga Policisë Bashkiake

Moduli i Policisë Bashkiake për të kontrolluar pagesat e parkimit të mjeteve në rrugë.

Funksionalitetet	Përshkrimi
Login /Kredencialet	
Kërkim në kohë reale sipas targës se mjetit (në një nderfaqe të vetme)	Kërkimi për një targë të caktuar duhet të jetë sa me i thjeshtë dhe në një ndërfaqe të vetme. Kërkimi duhet të kryzhet duke vendosur si parametër target e automjetit të parkuar. Sistemi do i kthej të dhënat e mëposhtme: - Targa e automjetit - Zonën e parkimit

	- Orën e fillimit të parkimit - Orën e mbarimit të parkimit - Kohën e mbetur për parkim (për të evituar gabimet e mundshme si pasojë e ndryshimit të orëve midis paisjeve dhe serverit qëndror)
--	---


2. Aplikacioni “Tirana Parking e-Wallet”

Ky Aplikacion ka si qëllim të lehtësojë procesin e pagesës së tarifës së parkimit për qytetarët që kërkojnë shërbimin e parkimit.


Funksionalitetet	Përshkrimi
Shkarkim nga app store dhe play store të aplikacionit mobile Tirana Parking	Aplikacioni mobile duhet të jetë i publikuar në App Store (Apple) dhe Play Store (Android) dhe qytetarët të kenë mundësi ta shkarkojnë atë falas.
Profili i Përdoruesit	Aplikacioni duhet të mundësojë krijimin e profileve të përdoruesve në mënyrë që të mund të ruajë të dhëna të ndryshme për veprimet dhe të ndjekë gjithashtu përdorimin e aplikacionit.
Portofoli digjital	Aplikacioni duhet të ofrojë një portofol digjital, në mënyrë që të rregjistrohen kreditet dhe më pas të mund të përdoren për të kryer pagesa të parkimit.
Ngarkim automatik i e-Voucher në portofolin digjital (Digital Wallet /e-Wallet) të Klientit	Nëpërmjet aplikacionit mobile, qytetarët do mund të ngarkojnë kreditet e blera me voucher dhe ti kenë ato në portofolin digjital të tyre.
Shkarkim automatik i pagesës së parkimit nga portofoli digjital (Digital Wallet /e-Wallet) të Klientit	Cdo herë që përdoruesi bën një pagesë nëpërmjet krediteve, ato duhet të zbriten nga kreditet e mbetura dhe të reflektohet në portofolin digjital të përdoruesit

Shënim: Workflow mund të ketë objekt ndryshimi gjatë periudhës së kësaj kontrate

Me poshtë është Workflow i Tirana Parking:



Më poshtë është paraqitur workflow i gjenerimit të voucher dhe përdorimi i tyre në aplikacionin mobile



13.2. Raporte

Sistemi duhet te gjenerojë raporte te ndryshme, sipas listës vijuese, jo shteruese:

- Raport për parkimet sipas filtrave perkatëes (kohorë, zone etj...)
- Raport ditor/periodik për për operatorët
- Raport ditor/periodik për për punonjësit bashkiak
- Raport ditor/periodik për pagesat sipas filtrave tipit të pagesës, orës së parkimit etj
- Raport ditor/periodik për kontrolluesit
- Raport i detajuar për kontrolluesit
- Raport ditor/periodik për për rrugët
- Raport ditor/periodik për për ngarkesën
- Raport ditor/periodik për Telefonat, Targat unike etj.
- Raporte financiare mbi tipin e pagesës (“voucher”, sms, “third-party”) sipas filtrave (kohorë, zonës etj.)
- Raporte statistikore mbi periudha kohorë etj.

Raportet duhet të kenë opsione për t’u printuar dhe për eksport në formatin PDF, xlsx, etj.

Sistemi duhet të jetë fleksibël për të mundësuar krijimin e raporteve të reja, të cilat do të diskutohen nga grupi i punës gjatë fazës së analizimit apo në fazat e mëvonshme, sipas nevojave dhe procedurave të funksionimit të platformës së Tirana Parking. Operatori ekonomik fitues duhet të jetë i gatshëm për zhvillimin e tyre pa kosto shtesë.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dhe nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sipas Shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin Vërtetim nga Drejtoria Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiar. Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën në një nga tre vitet e fundit financiar duhet të jetë jo më e vogël 40% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a) ISO 9001:2015 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të cilësisë.

-
- b) ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit.
- c) ISO 27001:2013 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

